

AKTI I THEMELIMIT
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“FOOD BOND”sh.p.k

Sot ne daten 07/02/2025 bazuar ne ligjin nr 9901 dt 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe shoqerite Tregtare” ortaku:

Z.CAI. YONGJU I datelindjes 17.01.1989 , qytetar kinez lindur ne Zhejiang, banues ne Tirane, me nr personal EJ6317137, vendosi te themeloje shoqerine

“FOOD BOND”sh.p.k

NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar quhet **“FOOD BOND”sh.p.k” sh.p.k.** dhe e ka seline ne adresen: Rruga Fitnete Rexha ,Njesia bashkiake nr.4, Godina nr.66

NENI 2

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte: Tregti te llojeve te ndryshme me shumice e pakice te produkeve ushqimore ,Import -export mallrave industriale, ushqimore, Bar-Restorant ,Konsulence ne fushen e nutricionit.

Tregtia me shumice dhe pakice te lendeve te para dhe mallrave qe hyjne tek produktet e gatshme dhe te konservuara ushqimore ne pergjithesi, tregtia me shumice dhe pakice te pijeve dhe lengjeve alkoolike dhe jo-alkoolike. SHPK-ja mund te veproje gjithashtu si agent i transferimit te parave per llogari te nje subjekti financiar jo-banke, te ofroje sherbime te ndryshme ne fushen e telekomunikacionit dhe te informatikes, veprimtari komisionere, industriale te te gjitha llojeve dhe cdo aktivitet tjeter qe nuk bie ndesh me legjislacionin ne fuqi

NENI 3

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike dhe financiare te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **“FOOD BOND”sh.p.k** do te jete pa afat.



NENI 4

Kapitali themelues i shoqerise 100.000 (dhjete mije), i shprehur ne 1 kuote me vlere 100.000 leke, i kontribuar nga ortaku:

Z.CAI. YONGJU 1 kuote me vlere 100,000 Leke.

Ky kapital mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit qe do te marri ortaku.

NENI 5

Administrator i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **FOOD BOND”sh.p.k**, do te jete Z.CAI. YONGJU I datelindjes 17.01.1989 , qytetar kinez lindur ne Zhejiang, banues ne Tirane, me nr personal EJ6317137, per nje periudhe 5 vjecare.

NENI 6

Administratori i shoqerise se lartpermendur, eshte i veshur me te gjitha atributet per drejtimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise, pa asnje perjashtim dhe kufizim. Ai ka mundesi te perpiloje te gjitha aktet qe konsiderohen te nevojshme per arritjen e qellimeve te shoqerise. Ai ka te drejte te bleje dhe te kembeje pasuri,te lidhet me shoqeri te tjera. Ai kryen cdo lloj veprimi prane te gjitha zyrave shteterore dhe private qe kane te bejne me garancite dhe veprimet hipotekore.

Te gjitha keto attribute do te shoqerohen rast pas rasti me autorizim te vecante nga ana e ortakeve te vetem dhe vetem ne kete menyre veprimet e administratorit marrin fuqi ligjore.

NENI 7

Veprimet ekonomiko-financiare te shoqerise mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti pervec urdhrave te vecanta qe jepen nga ortaku i vetem. Ne fund te cdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabel i shoqerise me rezultatin ekonomik,fitim-humbje, bazuar ne ligjet dhe rregullat e mbajtjes se kontabilitetit nga shoqerite private te percaktuara nga organet kompetente te sistemit fiscal.

Bilanci kontabel miratohet nga ortaku i vetem te shoqerise. Me miratimin e bilancit kontabel vjetor, ortaku i vetem vendos per krijimin e fondeve te ndryshme per shoqerine si ate te akumulimit, te rezerves etj.



NENI 8

Administratori ka te drejte te hyje ne marredhenie ekonomiko-financiare me autorizim te ortakut te vetem, me persona fizike dhe juridik, vendas apo te huaj, mbi bazen e kontratave, bazuar ne legjislacionin Shqiptar.

NENI 9

Ne marredhenie financiare shoqeria vepron me monedhen vendase, Lekun. Ajo ka te drejte te perdore edhe valuten e huaj konform legjislacionit ne fuqi.

NENI 10

Marredheniet e shoqerise me personelin e saj do te rregullohen mbi bazen e legjislacionit te punes. Shoqeria ka te drejte te pushoje cdo punonjes te personelit nga puna per shkak te indisciplinimit ose paaftesise profesionale duke kerkuar gjithashtu demshperblimin per demin e shkaktuar shoqerise nga punonjesit per faj te tyre.

NENI 11

Ne rast prishje te shoqerise, ortaket e vetem cakton nje likujdator i cili ne fund te likujdimit paraqet bilancin e likujdimit.

NENI 12

Ky akt themelimi hartohet ne kater kopje me vlere te barabarte secila.

ORTAKU I VETEM

Z.CAI. YONGJU

